



## PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS

### GJUHË C (1)

**Titullari /pedagogu i lëndës:** Dr. Markeliana Anastasi  
**Ngarkesa:** 4 kredite; 40 orë mësimore; 0 leksione / 40 seminare  
**Tipologjia e lëndës:** D  
**Viti akademik/Semestri kur zhvillohet:** Viti I / Semestri I  
**Lloji i lëndës:** Lëndë e detyrueshme  
**Programi i studimit:** Bachelor pranë Departamenteve të tjera FGJH  
**Kodi i etikës:** Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)  
**Adresa elektronike e titullarit/e pedagogut të lëndës:** [markeliana.anastasi@unitir.edu.al](mailto:markeliana.anastasi@unitir.edu.al)

### OBJEKTIVAT E LËNDËS DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

#### *Objektivat e përgjithshme lëndore:*

Lënda **Gjuhë C (1)** i drejtohet studentëve të vitit të parë bachelor (FGJH, UT), të cilët e zgjedhin atë si gjuhë të dytë. Lënda i shërben mësimin të gjuhës së huaj në nivel të fillestar gjuhësor. Ajo i shërben gjithashtu praktikës sociolinguistike të koncepteve bazë morfo-sintaksore. Kjo është një lëndë me karakter formues si në njohjen e një gjuhe ashtu dhe në njohjen e kulturës së saj. Ushtrimet janë strukturuar në mënyrë të tillë që të verifikohet përvetësimi i tyre si në aspektin ngushtë gjuhësor ashtu edhe në atë kulturor.

#### *Rezultatet e të nxënit:*

- *Zotërimi i një niveli gjuhësor fillestar*
- *Zotërimi i instrumentave shprehës të domosdoshëm për komunikimin në kontakt të parë me gjuhën italiane.*
- *Aftësia për t'u shprehur aq sa për të shkëmbyer informacionet bazë në komunikim.*
- *Kompetenca gjuhësore: aftësia për të lexuar, dëgjuar dhe folur me fjali të shkurtra në gjuhën italiane.*
- *Kompetenca shoqërore: nxitja e punës në grup, si një mënyrë mjaft efektive për përfshirjen e sa më shumë studentëve në procesin mësimdhënës dhe mësimnxënës.*
- *Kompetenca ndërkulturore: Aftësia për të analizuar aspekte të ndryshme socio kulturore dhe për qasjen e tyre me kulturën shqiptare.*